FLETUDHËZUES I PAKETIMIT:
Informacion për përdoruesin

INDERM 4%

Xhel – 40 mg / 1 g
(Eritromicin)

Lexojeni me kujdes fletudhëzuesin përpara se të filloni përdorimin e barit.
- Ruajeni fletudhëzuesin. Mund të keni nevojë ta lexoni përsëri.
- Nëse keni pyetje të mëtejshme, drejtohuni tek mjeku ose farmacisti juaj.
- Ky bar është përshkruar për ju personalisht. Mos ja jepni atë personave të tjerë. Mund t'i dëmtojë ata edhe nëse kanë të njëjtat simptoma si ju.
- Nëse ndonjë prej efekteve anësore ju shqetëson ose nëse vëreni efekte anësore, që nuk përmenden në këtë fletudhëzues, ju lutemi të njoftoni mjekun ose farmacistin tuaj.

Ky fletudhëzues përmban:

1. Çfarë është Inderm 4% dhe përse përdoret?
2. Çfarë duhet të kini kujdes përpara se të përdorni Inderm 4%?
3. Si ta përdorni Inderm 4%?
4. Efekte anësore të mundshme
5. Si ta ruani Inderm 4%?
6. Informacione të mëtejshme

1. ÇFARË ËSHTË INDERM 4% DHE PËRSE PËRDORET?
Inderm 4% përmban lëndën aktive eritromicin. Ai është një bar për trajtimin e jashtëm të akneve.
Inderm 4% përdoret në të gjitha format e lehta deri mesatare të akneve, kryesisht në format inflamatore, si aknet papulopustuloze (formim i nodujve dhe pustulave).
Përdoret i kombinuar me barna të tjera kundër akneve.

2. ÇFARË DUHET TË KINI KUJDES PËRPARA SE TË PËRDORNI INDERM 4%?
Inderm 4% nuk duhet të përdoret në rast mbindjeshmërie ndaj eritromicinës, etanolit, ose ndaj lëndëve ndihmëse të shënuar në pikën 6.

Tregoni kujdes të veçantë gjatë përdorimit të Inderm 4%
Pyesni mjekun ose farmacistin tuaj para përdorimit të Inderm 4%.

Përdorimi i Inderm 4% me barna të tjera
Ju lutemi të informoni mjekun ose farmacistin tuaj nëse merrni / përdorni, keni marrë / përdorur para pak kohësh, ose nëse keni ndërmend të merrni / përdorni barna të tjera, edhe nëse bëhet fjalë për barna të marra pa recetë.
Nëse përdoren njëkohësisht edhe preparate të tjera me efekt zhveshës të lëkurës (Peeling), mund të shpeshtohen irritimet e saj.

Shtatzënia dhe ushqyerja me gji
Nëse jeni shtatzënë apo ushqeni me gji, nëse dyshoni se jeni shtatzënë apo planifikoni një shtatzëni, këshillohuni me mjekun ose farmacistin përpara se të përdorni këtë bar.
Për shkak se përvojat janë të pamjaftueshme, Inderm 4% nuk duhet të përdoret gjatë shtatzënisë dhe ushqyerjes me gji.

Drejtimi i automjetit dhe përdorimi i makinerive
Nuk ka të dhëna se ky bar ndikon në aftësinë për të drejtuar automjetin apo për të përdorur makineri.

Udhëzime të rëndësishme për disa nga lëndët ndihmëse të Inderm 4%
Butilhidroksitolueni mund të shkaktojë reaksione lokale në lëkurë (p.sh. dermatit kontakti), irritime të syve dhe të mukozave.

3. SI TA PËRDORNI INDERM 4%?
Gjithmonë përdoreni Inderm 4% sipas udhëzimit të mjekut. Pyesni mjekun ose farmacistin tuaj nëse nuk jeni i sigurt.

Nëse nuk përshkruhet ndryshe nga mjeku, doza e zakonshme është:
Inderm 4% aplikohet në mëngjes dhe në darkë si shtresë e hollë në zonat e akneve të fytyrës, pasi kjo e fundit të jetë larë dhe tharë plotësisht.

Mënyra e përdorimit
Inderm 4% është vetëm për përdorim të jashtëm dhe nuk duhet të bjerë në kontakt me sytë, hundën, gojën dhe mukoza të tjera.

Kohëzgjatja e përdorimit
Pas 4 javësh përdorimi të Inderm 4%, kryesisht në format e lehta të akneve, terapia duhet të vazhdohet me eritromicin xhel 2%. Në total, trajtimi mund të zgjasë deri në 3 muaj.
Flisni me mjekun ose farmacistin tuaj nëse keni përshtypjen se efekti i Inderm 4% është shumë i fortë ose shumë i dobët.

Nëse keni përdorur një sasi më të madhe Inderm 4% sesa duhej
Mund të vazhdoni trajtimin me dozat e rekomanduara. Nuk priten efekte anësore nga një mbidozim afatshkurtër.

Nëse keni harruar të përdorni Inderm 4%
Mos përdorni një dozë të dyfishtë nëse keni harruar të përdorni dozën paraardhëse.

Nëse ndërprisni përdorimin e Inderm 4%
Mund të rrezikoni suksesin e trajtimit. Ju lutemi të flisni me mjekun ose farmacistin tuaj përpara se të ndërprisni trajtimin me Inderm 4%.
Nëse keni pyetje të mëtejshme mbi përdorimin e këtij bari, pyesni mjekun ose farmacistin.

4. EFEKTE ANËSORE TË MUNDSHME
Si të gjitha barnat, Inderm 4% mund të ketë efekte anësore, por që mund të mos shfaqen tek kushdo. Për vlerësimin e efekteve anësore janë përdorur treguesit e mëposhtëm të shpeshtësisë:

Shumë të shpeshta	Mund të preket më shumë se 1 ndër 10 përdorues
Të shpeshta	Mund të preket deri në 1 ndër 10 përdorues
Të pazakonta	Mund të preket deri në 1 ndër 100 përdorues
Të rralla	Mund të preket deri në 1 ndër 1.000 përdorues
Shumë të rralla	Mund të preket deri në 1 ndër 10.000 përdorues
Të panjohura	Shpeshtësia nuk mund të përcaktohet nga të dhënat që disponohen.

Në disa raste mund të shfaqen: skuqje inflamatore, formim petëzash, dhimbje, tharje e lëkurës, kruajtje ose yndyrë e tepërt për shkak të përmbajtjes së alkoolit në xhel. Në këto raste xheli duhet përdorur më rrallë.
Kontaktoni menjëherë mjekun nëse keni një reaksion serioz të lëkurës: rash i skuqur në trajtë luspash, me gunga nën lëkurë dhe flluska (pustulozë ekzantematoze). Shpeshtësia e këtij efekti anësor nuk dihet (nuk mund të vlerësohet nga të dhënat që disponohen).

Nëse ndonjë prej efekteve anësore ju shqetëson ose nëse vini re efekte anësore që nuk përmenden në këtë fletudhëzues, informoni mjekun ose farmacistin tuaj.

5. SI TA RUANI INDERM 4%?
Ruajeni barin larg fëmijëve!
Mos e ruani mbi 25 °C.
Nuk duhet ta përdorni barin pas datës së skadencës të shënuar në kuti dhe në tubet.

6. INFORMACIONE TË MËTEJSHME
Çfarë përmban Inderm 4%:
Lënda aktive është eritromicina.
1 g xhel përmban 40 mg eritromicin.

Lëndët ndihmëse janë: butilhidroksitoluen, hidroksipropil celulozë dhe etanol.

Përmbajtja e paketimit:
Kuti me një tubet 30 g.

Mbajtësi i Autorizimit për Tregtim dhe Prodhuesi:

PROFARMA sh.a.,
Rruga "Skënder Vila",
Tiranë, Shqipëri.
Tel.: +355 4 23 89 602

Ky fletudhëzues u rishikua për herë të fundit në Nëntor 2023.

SPECIFICATION

CROPING AREA 12 x 19 cm

PAY ATENTION, all the layers are visible. If you have to print this document please check or uncheck the specific layers.